



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 802/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.11.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k., në procedurën e prokurimit prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-79820-07-18-2018, me objekt “*Ndërtim i rrjetit të ri shpërndaes i furnizimit me ujë të qytetit Rrëshen*”, me fond limit 83.164.282 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 20.08.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k.
Kompleksi “Kthella Resort”, Rruga “Shën Vinçenzo De Paolo”, përballë varrezave, Rrëshen, Mirditë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Mirditë
Sheshi “Abat Doçi”, Rrëshen, Mirditë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit*”

publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.07.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-79820-07-18-2018, me objekt “Ndërtim i rrjetit të ri shpërndares i furnizimit me ujë të qytetit Rrëshen”, me fond limit 83.164.282 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 20.08.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

II.2. Në datën 20.08.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në

datë 19.09.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Curri” sh.p.k.	68.094.590 lekë, skualifikuar
2. “Be-Is” sh.p.k.	68.822.830 lekë, skualifikuar
3. BOE “Kupa” sh.p.k. & “Liqeni VII” sh.p.k.	69.453.066 lekë, skualifikuar
4. “Pe-Vla-Ku” sh.p.k.	70.773.353 lekë, skualifikuar
5. “4 A-M” sh.p.k.	71.217.314 lekë, skualifikuar
6. BOE “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k.	75.677.329 lekë, skualifikuar
7. BOE “AEK Munella” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k.	76.860.105 lekë, kualifikuar
8. “Hastoçi” sh.p.k.	78.262.007 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 19.09.2018, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

- 1. Vertetimet per shlyerjen e taksave vendore nuk jane te plota sipas ushtrimit te aktivitetit nga BOE.*
- 2. Dokumentacioni per punet e ngjashme nuk eshte i plote si dhe eshte jashte afatit tre vjecar.*
- 3. Mjeti autobot uji nuk rezulton i tille ne asnjerin rast, dhe jane mjete per transport mallra te rrezikshme (mjetet me targa AA380BB dhe AA933LT)*
- 4. Sipas shtojces 11, BOE nuk ka deklaruar sakte per kontratat e lidhura ose ne proces.*

II.5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k. në datën 26.09.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit, duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...]Ne lidhje me keto 4 arsye skualifikimi parashtrrojme si vijon:

Pretendimi 1 i Komisionit te Vleresimit te Ofertave (KVO-se), citoj...1-Vertetimet per shlyerjen e taksave vendor nuk jane te plota sipas ushtrimit te aktivitetit nga BOE

Argumentoj 1: Kjo arsye nuk qendron pasi shoqeria “KTHELLA” SHPK ushtron aktivitet ne Bashkine Mirdite (Ish bashkia Rreshen) dhe per kete adrese i ka paraqitur vertetimet te cilat po ua bashkelidhim (FILE Vertetim taksa vendor 2013-2018). Shoqeria “NDREGJONI” SHPK ushtron aktivitet ne Bashkine Tirane dhe per kete adrese i ka paraqitur vertetimet te cilat po ua bashkelidhim (FILE 1.7-NDREGJONI-Taksa vendor (2016-2017-2018) dhe NDREGJONI Taksa vendor 2015), per adresen Lagja 5 rruga Hysen Mushketa Durres nuk eshte paraqitur vertetim duke qene se ne kete adrese nuk eshte ushtruar aktivitet pasi punimet e ndertimit ne kete adrese jane konfirmuar te perfunduara nga bashkia Durres ne shkurt 2014 me ane te dokumentave Leje perdorimi nr 923 prot. date 14.02.2014 dhe shkreses me lende Konfirmin zyrtar i perfundimit te punimeve te ndertimit nr 923/1 prot. date 14.02.2014 (kopje te te cilave po ua dergoj bashkelidhur) pas kesaj date bashkia Durres nuk na ka derguar shkrese per pagim taksa vendore.

Pretendimi 2 i KVO-se, citoj... 2- Dokumentacioni per punet e ngjashme nuk eshte i plote si dhe eshte jashte afatit 3 vjecar

Argumentoj 2: Kjo arsye nuk qendron pasi punimet e ngjashme jane te plota si i kerkon ligji dhe DST si dhe jane brenda afatit 3 vjecar. Po ju bashkelidh formularet e vleresimit te te gjitha punimeve te ngjashme te paraqituara (FILE-et Rehabilitim i diges se ujeleshuesit Malaj I

Rehabilitim i rrjetit ujites Malaj I; Rruget Ymer h Prizreni... Bashkia Kamez; Ujesjellesi sorodol; 3-NDREGJONI-Pjesa 1-SIF IV Ndertim UJjesjellsi 199 faqe; 3-NDREGJONI-Pjesa 2- Kontrata SIF IV Ndertim Ujesjellsi 98 faqe; 3-NDREGJONI- Piesa 3- Kontrata SIF IV Ndertim Ujesjellsi 150 faqe).

Pretendimi 3 i KVO-se, citoj..... 3-Mjeti autobot uji nuk rezulton i tille ne asnjerin rast, dhe jane mjete per transport mallra te rrezikshme (mjetet me targa AA380BB dhe AA933L7).

Argumentoj 3: Kjo arsye nuk qendron pasi në dokumentat e tenderit është kërkuar 1 autobot dhe mjeti me targa AA380BB eshte i sakte si autobot dhe fakti qe ka edhe certifikatë për transport mallra te rrezikshme kjo nuk e ben ate te papershtatshem per malla jo te rrezikshme. Pervec ketij argument ju sqarojme se bashkimi i shoqerive tona ka paraqitur edhe nje autobot tjeter dhe konkretisht mjeti me targa KR7195A. Po ju bashkelidh dokumentat e te dy ketyre autoboteve (FILE-et 7- NDREGJONI- Autobot Uji - Autobitumatrice; Mjete me qera ujesjellesi rreshen pjesa 2).

Pretendimi 4 i KVO-se, citoj...4- Sipas shtojces 11, BOE nuk ka deklaruar sakte per kontratat e lidhura ose ne process.

Argumentoj 4: Kjo arse nuk qendron pasi ne daten 20.8.2018 kontratat e shoqerive KTHELLA SHPK & NDREGJONI SHPK jane ato qe jane deklaruar ne shtojcen 11 dhe situata e kontratave te shoqerive tona ne ate date eshte deklaruar e sakte. (FILE-et Shtojca e deklarata: NDREGJONI Shtojca - Deklarata).

Te gjitha arsyet e mesiperme edhe sikur te ishin te verteta (gje qe nuk jane) duhet te interpretohen si devijime te vogla qe nuk e cenojne thelbin e ofertes, kjo ne baze te nenit 53 pika 4 te Ligjit per prokurimin publik. Per sa me siper kerkojme nga KVO te rivleresoje duke e kualifikuar oferten tone.

II.6. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues pranë KPP, ky i fundit pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor në datën 04.10.2018. Ndërkohë që, referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit me anë të shkresës nr.4198/1 datë 03.10.2018, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar atë. Ndër të tjera, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

[...] Neni 30/4 i LPP-se percakton se Autoriteti Kontraktor (me ane te KVO-se) hap ofertat, verifikon kualifikimet apo mangesite e ofertuesve, ne baze te kriterëve te percaktuara ne nenet 45 e 46 te ketij ligji dhe perzgjedh kontraten fituese, pas krahasimit te ofertave, bazuar ne kriteret e percaktuara ne nenin 55 te ketij ligji.

Referuar nenit 46, pika 1 te ligjit Nr 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimit publik" (i ndryshuar) parashikohet shprehimisht: Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese", nenit 53 pika 3 e ligjit Nr 9643 date 20.11.2006"Per prokurimin Publik"i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te keti neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji. Per me teper, anetaret

e KVO-se ne cdo rast vleresojne ate dokumentacion i cili eshte ngarkuar ne sistem dhe ne rastin konkret ju keni mungesa. Si rrjedhim, subjekti juaj nuk plotëson kriteret e kërkuara në DST.

II.7. Në datën 12.10.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Njëpërmjet shkresës nr. 4544/1 prot., datë 24.10.2018, protokolluar me tonën në datën 26.10.2018, me objekt “*Informacion për procedurën e prokurimit “Ndërtim i rrjetit shpërndarës i furnizimit me ujë të qytetit Rrëshen”, Bashkia Mirditë*” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit të tij “*Vertetimet per shlyerjen e taksave vendore nuk jane te plota sipas ushtrimit te aktivitetit nga BOE*” nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.2.4 e “*Kapacitetit ekonomik dhe financiar*”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “*2.2.4 Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet per vitet 2015, 2016 dhe 2017.*”

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k. rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë “Kthella” sh.p.k. dhe shoqërisë “Ndregjoni” sh.p.k., nga ku shoqëria “Kthella” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 11.5% të punimeve, dhe shoqëria “Ndregjoni” merr përsipër të kryejë 88.5% të punimeve.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Kthella” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k., të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, për të përmbushur kriterin e mësipërm, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Ekstrakt i Regjistrimit Tregëtar i shoqërisë “Kthella” sh.p.k., lëshuar nga QKB
- Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregëtar i shoqërisë “Kthella” sh.p.k., lëshuar nga QKB.

- Vërtetim Nr.2147 prot., datë 11.04.2016 lëshuar nga Bashkia Mirditë, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Kthella” sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore ndaj Bashkisë Mirditë (përfshirë dhe Komunat dhe bashkitë respective që ka përfshirë kjo bashki me ndarjen e re territorial) për vitet 2013, 2014, 2015 dhe vitin aktual 2016.
- Vërtetim Nr.3340 prot., datë 15.08.2017 lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Mirditë, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Kthella” sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore për vitin 2017.
- Vërtetim Nr.35 prot., datë 03.07.2018 lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Mirditë, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Kthella” sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore për vitin 2018.
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregëtar i shoqërisë “Ndrejoni” sh.p.k., lëshuar nga QKB
- Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregëtar i shoqërisë “Ndrejoni” sh.p.k., lëshuar nga QKB.
- Vërtetim Nr.579 prot., datë 17.04.2015 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Ndrejoni” sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore për vitin 2015.
- Vërtetim Nr.841 prot., datë 25.05.2016 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Ndrejoni” sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore për vitin 2016.
- Vërtetim Nr.120929/1 prot., datë 25.04.2017 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Ndrejoni” sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore për vitin 2017.
- Vërtetim Nr.112969/1 prot., datë 16.04.2018 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Ndrejoni” sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore për vitin 2018.

III.1.4. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuere.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton se, në kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës një dokument që vërteton se kanë plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku këta operatorë ekonomikë kanë ushtruar aktivitetet për vitet 2015, 2016 dhe 2017. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k., rezulton se anëtari i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive, operatori ekonomik “Kthella” sh.p.k., referuar Ekstraktit të Regjistrimit Tregëtar, ky i fundit ushtron aktivitetet në Republikën e Shqipërisë me Zyrë Qëndrore në Rrëshen, Kompleksi Kthella Resort, Rruga “Shën Vincenzo De Paolo”, përballë varrezave të qytetit Rrëshen, si edhe referuar këtij Ekstraktit në pikën 14 *Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit* ushtron aktivitetet në disa adresa të tjera po në qytetin Rrëshen. Nga shqyrtimi i Ekstraktit Historik të kësaj shoqërie, rezulton se për vitin 2015, 2016 dhe 2017, kjo e fundit ka ushtruar aktivitetet vetëm në qytetin Rrëshen. Operatori ekonomik “Kthella” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm ka dorëzuar vërtetime të lëshuara nga Bashkia Mirditë (ku bën pjesë edhe Njësia Administrative Rrëshen), më anë të të cilave vërtetohet se kjo shoqëri nuk ka detyrime të taksave dhe tarifave vendore të pashlyera në këtë Bashki për vitet 2015, 2016, 2017.

Për sa i përket operatorit ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k., si anëtar i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive, nga shqyrtimi i Ekstraktit të Regjistrimit Tregëtar të kësaj shoqërie, rezulton se, kjo e fundit ushtron aktivitetet në Republikën e Shqipërisë me Zyrë Qëndrore në Tiranë, Njësia Bashkiake nr.8, Rruga “Sule Bega”, ndërtesa nr.32, hyrja 8, si edhe referuar këtij Ekstrakti nuk ka vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit. Nga shqyrtimi i Ekstraktit Historik të kësaj shoqërie, rezulton se për vitet 2015, 2016, 2017, kjo e fundit ka ushtruar aktivitetet në Bashkinë Tiranë dhe Bashkinë Durrës, konkretisht në datën 11.06.2012 është shtuar adresa *“Durrës, Lagja 5, Rruga “Hysen Myshketa”, pranë kopshtit Ivina”*, dhe në datë 16.03.2015 sipas ekstraktit, rezulton se është hequr adresa *“Durrës, Lagja 5, Rruga “Hysen Myshketa”, pranë kopshtit Ivina”*, pra me anë të këtij ekstrakti rezulton se, shoqëria “Ndregjoni” sh.p.k. për vitin 2015 ka ushtruar aktivitetet në bashkinë Tiranë dhe në Bashkinë Durrës. Operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm ka dorëzuar vërtetime të lëshuara nga Bashkia Tiranë, më anë të të cilave vërtetohet se

kjo shoqëri nuk ka detyrime të taksave dhe tarifave vendore të pashlyera në këtë Bashki për vitet 2015, 2016, 2017, por ky operator ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim se ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Durrës për vitin 2015, për sa kohë që nga Ekstrakti i kësaj shoqërie rezulton se ka kryer aktivitetet në Bashkinë Durrës deri në datë 16.03.2015.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i ekstraktit historik të shoqërisë, të lëshuar nga QKB dhe vërtetimeve të lëshuara nga institucioni vendor i bashkisë ku operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. ka ushtruar aktivitetet, rezulton se ky i fundit nuk ka vërtetuar se ka shlyer detyrime lidhur me taksat dhe tarifave vendore për vitet 2015, në të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin e tij tregtar, konkretisht për Bashkinë Durrës.

KPP arsyeton se, duke qenë se sipas legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar, në përputhje me ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, të kryejë regjistrimet në regjistrin tregtar, të kryejë regjistrimin e subjekteve të përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të inspektimit të marrëdhënieve të punës, të lëshojë certifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve të depozituara, të publikojë të dhënat e regjistruara, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to, atëherë edhe verifikimi i vendeve ku shoqëria “Ndregjoni” sh.p.k. ka kryer aktivitetin e saj gjatë vitit 2015 do të bëhet referuar ekstraktit të publikuar nga QKB për këtë shoqëri.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. si një nga anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj vendeve ku ka ushtruar aktivitetet për vitin 2015, pra, rrjedhimisht, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k., nuk plotësojnë kërkesën e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me shlyerjen e taksave vendore për vitet 2015, 2016, 2017.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k. mbi arsyet e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-79820-07-18-2018, me objekt “*Ndërtim i rrjetit të ri shpërndaresh i furnizimit me ujë të qytetit Rrëshen*”, me fond limit 83.164.282 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 20.08.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1590 Protokolli

Datë 12.10.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

